

	APLIKACIONI PËR TARIFA	FO-ÇRT-012
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 1 nga 5</i>

25.01.2022

Komente ndaj Raportit Konsultativ për Shqyrtimin e Jashtëzakonshëm të të Hyrave Maksimale të Lejuara të Energjisë Elektrike për Operatorët e Rregulluar

Hyrje

KOSTT me datë 17 janar 2022, ka pranuar nga ZRrE Raportin Konsultativ për Shqyrtimin e Jashtëzakonshëm të të Hyrave të Lejuara Maksimale të Energjisë Elektrike për Operatorët e Rregulluar.

Në vazhdim KOSTT paraqet komentet ndaj këtij raporti.

Të Hyrat Maksimale të Lejuara të Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut

KOSTT ka analizuar parametrat e llogaritjes së kostove për të hyrat e lejuara të vitit 2022 dhe trajtimi i disa kategorive nuk përkon me gjendjen financiar aktuale të kompanisë, kurse disa prej tyre nuk reflektojnë trendet aktuale të kostove në bursat e energjisë.

Humbjet në transmetim

Çmimi mesatar i parashikuar i humbjeve në transmetim prej 108.16 €/MWh, për vitin 2022 është çmim shumë i ulët në krahasim me çmimet aktuale gjatë muajit janar në bursat e energjisë elektrike në rajon dhe Evropë. Gjatë këtij muaji deri më tani kostoja e humbjeve në transmetim ka arritur rreth 4 milionë euro, që ende pa përfunduar muaji ka arritur pothuajse një të tretët e kostos së tërë vitit. Mungesa e mjeteve financiare në KOSTT si pasojë e obligimit për mbulimin e humbjeve në pjesën veriore të Kosovës, dhe pagesave sipas udhëzimeve të Parlamentit të Kosovës rrezikohet edhe më tej me parashikime të kostove me vlera më të ulëta se sa kostoja aktuale që është duke ndodhur.

KOSTT ka bërë llogaritjet e reja për parashikimin e kostos së humbjeve në transmetim për vitin 2022, duke u bazuar në parashikimi të rrjedhave të energjisë të Bilancit të Energjisë Elektrike Versioni 0.5 dhe parashikimin e çmimeve të importit të energjisë elektrike për vitin 2022 nga Task Forca e themeluar nga Ministria e Ekonomisë për krizën energjetike. Sipas këtyre dy dokumenteve sasia e humbjeve në transmetim parashikohet të jetë 136.3 GWh kurse çmimi mesatar 150.72 €/MWh.

Andaj, ju lutemi për rishikimin e pozicionit të humbjeve dhe përfshirjen e kostos së parashikuar nga KOSTT prej 20,543,661.9 euro.

Tabela 1. Parashikimi i kostos së humbjeve në transmetim për vitin 2022

Muaji	Humbjet në transmision [MWh]	Importi i humbjeve në transmision [MWh]	Blerja nga KEK [MWh]	Çmimi i blerjes së humbjeve me kontratë nga KEK [€/MWh]	Kostoja mesatare e blerjeve nga KEK [€]	Çmimi mesatar i blerjes së humbjeve nga Importi	Kostoja mesatare e parashikuar nga importi [€]	Çmimi mesatar mujor i përfaqësuar sipas muajve [€/MWh]	Kostoja totale e përfaqësuar sipas muajve [€]
1	16012	14,368	1644	36.00	59,167	262.00	3,764,505.30 €	238.80	3,823,672.33
2	13706	9,816	3890	36.00	140,048	271.32	2,663,240.65 €	204.53	2,803,288.43
3	13551	5,372	8179	36.00	294,445	235.27	1,263,828.52 €	114.99	1,558,273.26
4	11286	5,718	5567	36.00	200,422	199.44	1,140,468.61 €	118.81	1,340,890.89
5	7596	1,677	5919	36.00	213,089	190.23	319,001.30 €	70.05	532,090.55
6	7999	352	7646	36.00	275,264	197.98	69,746.41 €	43.13	345,009.97
7	8273	5,696	2578	36.00	92,794	202.03	1,150,713.49 €	150.30	1,243,507.11
8	8491	6,409	2082	36.00	74,970	203.11	1,301,710.56 €	162.13	1,376,680.14
9	9048	4,642	4406	36.00	158,622	203.11	942,840.36 €	121.73	1,101,461.97
10	11532	5,280	6252	36.00	225,062	217.32	1,147,494.48 €	119.02	1,372,556.49
11	13405	8,859	4546	36.00	163,648	217.32	1,925,306.13 €	155.83	2,088,954.03
12	15402	13,252	2150	36.00	77,403	217.32	2,879,873.32 €	192.01	2,957,276.74
Gjithsej	136301	81442	54859		1,974,932.78 €		18,568,729.1 €		20,543,661.9 €

Shërbimet ndihmëse

ZRRë në Raportin Konsultativ ka trajtuar ndryshe kostot e shërbimeve ndihmëse në krahasim me vitet e tjera. Kostot e lejuara për këtë kategori gjatë periudhës 2007-2020 në vlerë prej 5.9 milionë euro janë azhurnuar me kostot e parashikuara nga KOSTT prej 12.87 milionë euro dhe si rrjedhojë janë përfshirë vetëm 7 milionë euro në të hyrat e vitit 2022.

KOSTT dëshiron të vejë në pah se fillimisht për periudhën e cekur KOSTT në librat e kontabilitetit ende i ka detyrimet e hapura ndaj EMS, të cilat për arsye të njohura politike nuk janë paguar.

Gjatë vitit 2021, për humbjet në komunat veriore të Kosovës sipas udhëzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës KOSTT ka paguar rreth 33 milionë euro, me mjete nga fitimi i pashpërndarë një pjesë e të cilit kanë qenë nga të hyrat për shërbime ndihmëse të periudhës 2007-2010.

Duke marrë parasysh se KOSTT nuk posedon më këto të hyra, ky trajtim shkakton dëm financiarë për kompaninë dhe si rrjedhojë nuk do të jetë në gjendje të paguajë detyrimet për shërbime ndihmëse gjatë vitit 2022. Andaj, kërkohet nga ZRRë, përfshirjen e kostos së plotë për këto shërbime sipas parashikimit prej 12.87 milionë euro.

Fondi për BRE

Azhurnimi i Fondit për BRE gjithashtu paraqet rrezik potencial për degradimin e situatës financiare të KOSTT e cila vetëm se është shumë e rënduar. Azhurnimi i fondit për 7.02 milionë euro nga viti paraprak, nuk përkon me gjendjen aktuale në KOSTT, pasi që këto mjete janë shfrytëzuar për mbulimin e humbjeve në pjesën veriore dhe si rrjedhojë, mos përfshirja e të hyrave për fond sipas parashikimeve do të ketë për pasojë mungesën e mjeteve në Fondin për

BRE për shlyerjen e detyrimeve ndaj palëve dhe ekspozimin e kompanisë ndaj rreziqeve të proceseve gjyqësore të cilat mund të ngritën nga palët.

Gjithashtu duhet cekur se Fondi për BRE, në vitin 2021 ka një mungesë prej 191,690 € si pasojë e mos pagesës së subvencionimit nga Qeveria e Kosovës. Kjo mund të shihet edhe në llogaritjet për realizimin e fondit në vitin 2021 e cila i është bashkëngjitur dokumentit.

Detyrimet e mbetura të KEK ndaj konsumatorëve

Në Raportin Konsultativ të lëshuar nga ZRrE thuhet se detyrimet e mbetura të KEK ndaj konsumatorëve, janë alokuar tërësisht në tarifat e KOSTT në vlerë prej 5.9 milionë euro. Pra, të hyrat e KOSTT janë zvogëluar për këtë vlerë duke mos cekur mënyrën e shlyerjes së këtij detyrimi të KEK ndaj KOSTT. Bazuar në të dhënat aktuale nga viti 2017 deri në vitin 2022, KEK nuk ka mundësi të furnizimit të KOSTT me energji elektrike për shlyerjen e detyrimit në nivelin prej 5.9 milionë euro brenda një viti duke marrë parasysh detyrimet që i ka ndaj furnizuesit të shërbimit publik universal dhe detyrimeve tjera.

Andaj, KOSTT kërkon nga ZRrE që të përcaktohet qartë forma e përmbushjes së detyrimit të KEK ndaj konsumatorëve përmes tarifave të KOSTT, me qëllim të minimizimit të rrezikut financiarë që paraqet ky detyrim për KOSTT-in.

Sipas llogaritjeve nga Bilanci i vitit 2022, vlera e humbjeve që mund të mbulohen nga KEK është rreth 1.9 milion euro, që nënkupton se KEK duhet të kompensojë KOSTT-in me mjete financiare përmes transferit bankar rreth 4 milionë euro.

Obligimi i mbulimit të humbjeve në pjesën veriore të Kosovës

Detyrimi i vendosur nga ZRrE përmes Licencës për Operatorin e Sistemit të Transmetimit për mbulimin e humbjeve në pjesën veriore të Kosovës duke mos përfshirë të hyrat për koston e kësaj energjie e ka sjellë KOSTT-in në prag të falimentimit.

Kosotoja e humbjeve në pjesën veriore gjatë vitit 2021 ka arritur vlerën prej 40,849,659 euro. Nga Qeveria e Kosovës janë mbuluar rreth 7,673,462 milionë euro, pjesa tjetër prej 33,176,197 euro është mbuluar nga buxheti i KOSTT sipas udhëzimeve të Parlamentit të Kosovës. Si rrjedhojë, Bilanci i Suksesit të kompanisë me 31 dhjetor 2021, paraqitet negativ, pra me humbje rreth 25 milionë euro. Të gjitha parashikimet financiare për vitin 2022 me skenarët ku obligimi i mbulimit të humbjeve në pjesën veriore i mbetet KOSTT pa të hyra për këtë kosto, e sjellin kompaninë në prag të falimentimit në tremujorin e parë të vitit 2022.

Prandaj, KOSTT kërkon nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë që urgjentisht të ia largojë obligimin e mbulimit të humbjeve në pjesën veriore të Kosovës nga Licenca për Operatorin e Sistemit të Transmetimit ose të gjejë një mekanizëm tjetër të mbulimit të kësaj kostoje.

Kostoja e devijimeve ndaj interkoneksionit

Devijimet ndaj interkoneksionit të zonës rregulluese të KOSTT gjatë vitit 2021 kanë qenë të mëdha, sidomos gjatë muajve nëntor dhe dhjetor.

Një pjesë e këtyre detyrimeve mbulohen nga mekanizmi balancues për devijimet e paqëllimshme nga palët tregtare. Pjesa e shkaktuar nga KEDS dhe KESCO me nën-nominimet gjatë muajit dhjetor sipas Raportit Konsultativ janë përfshirë në të hyrat e tyre dhe ne presim që këto detyrime do të paguhen sapo të aprovohen të hyrat e vitit 2022.

Pjesa tjetër e cila mbetet si detyrim i KOSTT kanë arritur vlerën rreth 12,381,093 euro dhe kërkojmë që këto kosto të përfshihen në të hyrat maksimale të lejuara për vitin 2022. KOSTT do të jetë i detyruar të ia paguajë JAO (Joint Allocation Office), përmes mekanizmit FSkar të vendosur nga ENTSO-E të gjitha këto kosto për të cilat vetëm se janë pranuar faturat.

Përmbledhje

Gjendja financiare e kompanisë KOSTT është jashtëzakonisht e rënduar. Nëse vazhdohet ky trend, parashikimet financiare e vendosin kompaninë në prag të falimentimit në tremujorin e parë të këtij viti.

KOSTT kërkon nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë që gjatë procesit të vendosjes së të hyrave dhe kostove për këtë vit të merret parasysh ndër të tjera edhe likuiditeti i kompanisë.

Kërkesat të cilat janë paraqitur në këtë dokument janë vitale për zvogëlimin e rrezikut financiarë dhe ruajtjen e sigurisë së operimit të sistemit të transmetimit.

Fundi i Dokumentit